

Zhvillohet në platformën online takimi i Grupit të Punës së EUROSAT për IT (ITWG)

29.11.2024

Në datë 29 nëntor 2024 u zhvillua në platformën online takimi i organizuar nga Grupi i Punës i EUROSAT për IT me pjesëmarrjen e SAI-ve anëtare.

Takimi u hap me një përmbledhje të shkurtër të aktiviteteve kryesore të vitit 2024. Ky vit u konsiderua si një vit tranzitor por mjaft i rëndësishëm. ITWG arriti në 45 anëtarë me përfshirjen dhe të SAI-t të Izraelit në muajin qershor. Gjithashtu, brenda vitit 2024 u miratua plani i ri i punës 2024-2027 në kongresin virtual të EUROSAT-t.



The screenshot shows a Zoom meeting interface with a central slide. The slide title is "EUROSAT ITWG in 2024 - a year of transition". The slide content includes:


- Now 45 members (SAI Israel joined in June 2024)
- New work program for 2024-2027, endorsed at EUROSAT (virtual) congress
- SAI Estonia as the chair until 2027
- 2 major events + coffee-breaks with the colleague + eGov subgroup meeting
- Developments in projects –
 - eGov subgroup - Audit Portfolio (CUBE and AITAM)
 - Research & Training Hub
 - Cooperative audits (+ occasional benchmarking)
 - ITSA/ITASA (planning ahead)
- Collaboration with ARABOSAI + interest from AFROSAT-E

Takimi vijoi me bashkëbisedimin mbi një listë temash potenciale për t'u diskutuar dhe zhvilluar me tej në takimet e ardhshme të ITWG për gjatë vitit 2025, tema të cilat u propozuan gjatë sondazhit të verës 2024 dhe që paraqiten si më poshtë vijon:

- Auditim gjithëpërfshirës duke integruar teknologjinë e informacionit në fusha të tjera auditimi;
- Auditimi në TIK i ofruesve të infrastrukturave kritike;
- Siguria e informacionit dhe sfidat e tjera të teknologjisë së informacionit nëpër bashki;
- Projektet PPP në fushën e teknologjisë së informacionit/ sektori privat dhe publik në zhvillimin e teknologjisë së informacionit dhe ofrimin e shërbimeve elektronike për qytetarët;
- Future-proof crypto solutions/ përdorimi praktik i blockchain;
- Identiteti elektronik dhe zgjidhje të ndryshme PKI;
- Arkitektura kombëtare e teknologjisë së informacionit (si nga këndvështrimi i menaxhimit kombëtar të TI-së dhe infrastrukturës kombëtare të TI-së);
- Zhvillimi i shërbimeve elektronike pa probleme;
- Zbatimi dhe pajtueshmëria me direktivën NIS2 në entet publike;
- Shërbimet elektronike të ofruara nga palët e treta për qeverinë.

Ndër temat më të votuara sipas këtij sondazhi u përzgjedhën:

- Auditimi në TIK i ofruesve të infrastrukturave kritike;
- Auditim gjithëpërfshirës, duke integruar teknologjinë e informacionit në fusha të tjera auditimi;
- Sfidat e funksionimit të teknologjisë së informacionit në një SAI;
- Future-proof crypto solutions/ përdorimi praktik i blockchain.



Sekretariati i ITWG po planifikon një kurs auditimi të teknologjisë së informacionit mbi risitë në këtë fushë si: inteligjenca artificiale, blockchain, zgjidhjet cloud etj. Aktualisht është duke u zhvilluar kurrikula: “*Auditimi i Inteligjencës Artificiale në Sektorin Publik*” e konfirmuar deri tani nga SAI i Sllovenisë, Hollandës, Estonisë, SHBA-ve, Izraelit dhe Gjermanisë.

Gjithashtu, ECA dhe Izraeli kanë propozuar rritjen e bashkëpunimit në fushën e Inteligjencës Artificiale, duke marrë në konsideratë zhvillimet e shpejta teknologjike dhe lehtësitë që ato sjellin në proceset e auditimit (zbatimi praktik i Inteligjencës Artificiale në SAI dhe në auditimet e veprimtarisë qeveritare). Me qëllim arritjen e këtij objekti u propozua një shkëmbimi i rregullt i informacionit ndërmjet ekspertëve të fushës, duke zhvilluar një matricë dinamike për monitorim të vazhdueshëm të temës në fjalë.

Në cilësinë e anëtarit të këtij grupi pune, nga KLSH takimi u ndoq nga audituesit e Departamentit të Auditimit IT.